



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit

Programi i studimit: Program Fillor

Niveli i studimeve:
Bachelor

Numri i kredive:
240 ECTS

Akredituar për periudhën:
1 Tetor 2016- 30 Shtator 2019

Hartimi i këtyre materialeve është bërë me ndihmën e projektit "Modernizimi i Shkollimit të Mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës, nr. 544023" financiar nga Bashkimi Europian.

The European Commission support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents which reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.

PËRMBAJTJA:

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	4
2. REZULTATET E PRITURA:	5
3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi fillor	6
4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS:	9

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Aftësimi i studentëve për të realizuar lëndët mësimore të shkollimit fillor (gjuha amtare, matematika, natyra, shoqëria, ato të kulturës muzikore, të artit dhe shëndetësore, si dhe zbatimin e teknologjisë arsimore).

Përgatitja e studentëve për promovimin, organizimin, evaluimin dhe realizimin e kurrikulumit arsimor në mënyrë efektive të nxënësit, prindërit dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Potencimi i opsioneve të ndryshme të studimit-mësimit, të çështjeve edukativo-arsimore në kuadër të arsimit fillor.

Sistemi i kredive mundëson thellimin në njohjen e fushave të caktuara në kuadër të lëndëve zgjedhore, përveç lëndëve obliguese të programit.

Aftësimi për përdorimin dhe zbatimin e të arriturave bashkëkohore në fushën e arsimit fillor si dhe zbatimi i teknologjisë informatike në zhvillimin e aktiviteteve me nxënësit e shkollës fillore (klasa I deri V).

Njohja me përmbajtjet interdisiplinore dhe arsimit inkluziv.

Familjarizimi me punën në institucionet e shkollave fillore gjatë realizimit të praktikave profesionale, që zhvillohen në kuadër të didaktikave specifike.

Të kuptuarit e rëndësisë së praktikës në institucionet shkollore.

2. REZULTATET E PRITURA:

Gjatë studimeve katër vjeçare pritet që studentët të aftësohen në:

- Krijimin e një përvoje paraprake përmes mësimit praktik, mbi procesin e mësimit dhe mësimit dhe mësimit;
- Menaxhimin e suksesshëm të klasës;
- Marrjen e një roli aktiv në ngritjen e cilësisë së të nxënësve tek nxënësve në shkollë;
- Krijimin e një klime pozitive në klasë dhe organizimin e mësimit përmes formave të llojllojshme;
- Krijimin e raporteve profesionale me mësimit, drejtorët dhe prindërit;
- Ndërlidhjen e informacioneve teorike me punën praktike me nxënësve në shkollë, me fëmijët e grupmoshave përkatëse;
- Në aplikimin e parimeve inkluzive në procesin edukativ arsimor;
- Ushtrimin e profesionit të mësimit bazuar në parimet bashkëkohore të mësimit, etj.

3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi fillor

VITI I PARË SEMESTRI I

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Gjuhë shqipe I	O	3+2	6
2.	Matematikë elementare I	O	3+2	6
3.	Gjuhë angleze I	O	2+2	6
4.	Filozofi e edukimit	O	3+1	6
5.	Shkathtësitë e mësimit akademik	O	2+2	6
Gjithsej			13+9	30

SEMESTRI II

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Gjuhë shqipe II	O	3+2	6
2.	Matematikë elementare II	O	3+2	6
3.	Hyrje në psikologji	O	3+2	5
4.	Bazat e arsimit muzikor me metodologji	O	3+1	5
5.	Metodologji e përgjithshme me praktikë	O	2+1	4
6.	Komunikimi në arsim	Z	2+1	4
7.	Historia e arsimit kombëtar	Z	2+1	4
8.	Vizatim	Z	2+1	4
Gjithsej			16+9	30

VITI I DYTË SEMESTRI III

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Gjuhë shqipe III	O	3+2	6
2.	TIK në edukimin fillor	O	3+2	6
3.	Teori e mësimit	O	3+2	6
4.	Gjuhë angleze II	O	2+1	4
5.	Interpretim me instrumente	Z	2+1	4
6.	Edukatë qytetare	Z	2+1	4
7.	Edukim fizik dhe shëndetësor	Z	2+1	4
8.	Shkathtësitë e komunikimit me fëmijë	Z	2+1	4
Gjithsej			15+9	30

SEMESTRI IV

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Letërsi për fëmijë	O	3+2	6
2.	Metodologji e mësimit të matematikës I	O	3+2	6
3.	Praktika pedagogjike II (5 javë)	O	2+1	4
4.	Histori kombëtare	O	3+2	6
5.	Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla	Z	2+1	4
6.	Artet e bukura	Z	2+1	4
7.	Punë dore me modelim artistik	Z	2+1	4
8.	Strategjitë dhe metodat e shkrim leximit	Z	2+1	4
Gjithsej			15+9	30

**VITI I TRETË
SEMESTRI V**

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Metodologji e shkencave Shoqërore	O	3+2	6
2.	Metodologji e arteve figurative	O	3+2	6
3.	Praktikë ped. III (6 javë)	O	2+0	4
4.	Bazat e shkencave natyrore metodologji I	O	3+2	6
5.	Shkolla dhe komuniteti	Z	2+1	4
6.	Arsimimi gjatë gjithë jetës	Z	2+1	4
7.	Tendencat bashkëkohore në arsim	Z	2+1	4
8.	Metodologji e leximit letrar	Z	2+1	4
9.	Statistikë elementare	Z	2+1	4
Gjithsej			15+8	30

SEMESTRI VI

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Bazat e shkencave natyrore metodologji II	O	3+2	6
2.	Edukimi gjithëpërfshirës me metodologji	O	3+2	6
3.	Psikologji edukimi	O	2+2	5
4.	Edukimi mjedisor	O	2+2	5
5.	Zhvillimit i kurrikulave	Z	2+1	4
6.	Vështirësitë në të nxënë	Z	2+1	4
7.	Gj. angleze për mësues	Z	2+1	4
8.	Etika e mësimitdhënies	Z	2+1	4
9.	Edukimi dhe mediet	Z	2+1	4
Gjithsej			14+8	30

**VITI I KATËRT
SEMESTRI VII**

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Metodologji e mësimit të matematikës II	O	3+2	6
2.	Histori e letërsisë kombëtare	O	3+2	5
3.	Metodologji e edukimit fizik	O	3+2	5
4.	Metodologji e gjuhës shqipe	O	3+2	6
5.	Etnologji dhe letërsi popullore	Z	2+1	4
6.	Vlerësimi në arsim	Z	2+1	4
7.	Psikologjia zhvillimore dhe e personalitetit	Z	2+1	4
8.	Menaxhimi i klasës dhe disiplina	Z	2+1	4
9.	Fëmijët dhe mësimi në natyrë	Z	2+1	4
Gjithsej			16+10	30

SEMESTRI VIII

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Bazat e hulumtimit në edukim	O	2+1	6
2.	Praktika pedagogjike IV (8 javë)	O		14
3.	Provim përfundimtar	O		10
Gjithsej			2+1	30

4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS:

Përshkrimi për secilin kurs	
1	<p>Gjuhë shqipe I</p> <p>Gjuha si mjet komunikimi; gjuha si dukuri shoqërore e si sistem shenjash; shumësia e gjuhëve, familjet e nënfamiljet e gjuhëve; gjuha - populli – kombi – shteti (raportet, përkimet); piramida gjuhësore; gjuhësia; origjina dhe historia e gjuhës shqipe; fonetika; fonetika nyjetimore; fonetika akustike; klasifikimi i tingujve zanorë dhe bashkëtingëllorë; fonologjia; ndryshimet fonemore – kombinatorike (të gjalla e historike); prosodia, rrokja, theksi, intonacioni; tingulli, grafia, fonema; drejtshkrimi/drejtshqiptimi.</p>
2	<p>Matematikë elementare I</p> <p>Në këtë kurs studentët do të marrin informacione nga logjika matematikore, teoria e bashkësive dhe e relacioneve binare, që paraqesin një kaptinë të rëndësishme të matematikës bashkëkohore. Relacionet e dinamizojnë punën me bashkësi dhe krijojnë hapësirë për zhvillimin e të menduarit “kritik” të studentëve. Nga ana tjetër, bashkësia e numrave natyrorë N, bazohet në sistemin aksiomatik të Peanos dhe arsyetohet kërkesa për zgjerimin e saj, në numra të plotë Z, racional Q dhe real R. Zgjidhja e shumë problemeve nga jeta e përditshme bazohet në zgjidhjen e ekuacioneve dhe inekuacioneve, që janë gjithashtu tema studimi të këtij kursi.</p>
3	<p>Gjuhë angleze I</p> <p>Kursi, <i>Gjuhë angleze</i>, i ekspozon studentët ndaj mësimit të gjuhës angleze për qëllime të përdorimit të përditshëm në komunikim, shfrytëzim të literaturës bazike në gjuhën angleze, që u nevojitet në studimet e tyre. Kursi gjithashtu synon edhe përgatitjen/vetëdijesimin themelor për aspektet e mësimdhënies së gjuhës angleze për fëmijët e klasave fillore (1-5).</p>
4	<p>Filozofi e edukimit</p> <p>Ky kurs do t’u ndihmojë studentëve që të kuptojnë nocionet themelore të edukatës, historinë e edukimit dhe të shkollës gjatë etapave të zhvillimit shoqëror, konceptcionet e filozofëve dhe pedagogëve të mëdhenj si dhe me teoritë bashkëkohore të edukimit si: pragmatizmi, edukimi progresiv, kognivizmi, konstruktivizmi, humanizmi etj.</p>
5	<p>Shkathtësitë e mësimit akademik</p> <p>Përmbajtja e kursit përfshin informacione nga njohuritë dhe shkathtësitë e ndryshme akademike si: shkathtësitë e leximit dhe llojet e leximit dhe shkrimit akademik,</p>

	krijimi dhe shkrimi i raporteve akademike, përvetësimi i aftësive për prezantime individuale, dhe zhvillimi i shkathtësive të komunikimit dhe reflektimit me një të menduar kritik dhe krijues.
6	<p>Gjuhë shqipe II</p> <p>Emri (gjinia, numri, rasa, trajta, rasat e shquarsisë, lakimet e emrit); mbiemri; numërori; përemri (kuptimi, klasifikimi i përemrave); përemri (përemri dëftor, përemri lidhor); përemri (përemri i pacaktuar, përemri pronor, përemri pyetës); folja (kategoritë, format veprorë e joveprorë, trajta vetvetore, mënyrat, format e pashtjelluara, kohët, vetat dhe numri, zgjedhimet, tipat e zgjedhimeve, zgjedhimi vepror); ndajfolja; parafjala; lidhëza; pjesëza; pasthirrma.</p>
7	<p>Matematikë elementare II</p> <p>Ky kurs është vazhdimësi e kursit, Matematika elementare I. Përmes këtij kursi studentët do të zgjerojnë njohuritë themelore nga gjeometria statistika dhe probabiliteti. Fillohet me idenë e ndërtimit dhe organizimit aksiomatik të gjeometrisë elementare (të Euklidit), që është më i përshtatshëm për interpretimin e gjeometrisë në nivelin fillor/parashkollor, që në fakt është një modifikim i sistemit aksiomatik të Hilbertit. Bazuar në këtë model aksiomatik, në kurs trajtohen konceptet bazike të planimetrisë dhe të stereometrisë. Po kështu, në kurs trajtohen edhe transformimet izometrike siç janë: simetria qendrore, simetria boshtore dhe ajo rrafshore, si dhe homotetia dhe ngjashmëria. Vargjet numerike (aritmetike dhe gjeometrike), elemente të probabilitetit dhe statistikës.</p>
8	<p>Hyrje në psikologji</p> <p>Kursi do t'i njohë studentët me konceptet bazë që e përkufizojnë psikologjinë, me fushën e studimit, teoritë themelore, me metodologjinë e saj si dhe zbatimin e psikologjisë në praktikë. Në përgjithësi lënda përfshin bazat e psikologjisë së përgjithshme, njohuritë e proceseve bazike në psikologji, si dhe të atyre superiore. Përmes kësaj lënde pretendohet të qartësohen proceset e ndryshme mendore dhe sjellja e njeriut sipas gjurmimeve shkencore apo empirike. Ndërlidhja e informatave të ndryshme që trajtohen, do të jetë tema kryesore e njohurive të përfituara e të arritura nga studentët. Studentët do të njoftohen me bazat e krijimit të psikologjisë si shkencë moderne. Ata do të mësojnë për proceset intelektuale, kognitive dhe emocionale dhe metodat e mjetet e hulumtimit të këtyre proceseve</p>
9	<p>Bazat e arsimit muzikor me metodologji</p> <p>Ky kurs është me rëndësi të veçantë në Fakultetin e Edukimit, me shtrirjen e këtij</p>

	<p>kursi edhe tek programi fillor. Studentët nevojë prioritare e kanë të mësuarit e shkrim- leximit muzikor, duke u aftësuar që të këndojnë dhe interpretojnë në instrument me anë të notacionit muzikor.</p>
10	<p>Metodologji e përgjithshme me praktikë I</p> <p>Gjatë kursit do të fokusohen çështjet që kanë të bëjnë me njohjen dhe të kuptuarit e praktikave mësimore në kuadër të arsimit fillor. Fillimisht gjatë ligjëratave do të shqyrtohen qasjet teorike të edukimit, ku do të theksohet veçanërisht njohja me trendet bashkëkohore të edukimit fillor. Në praktikën mësimore, e cila zgjat dy javë, studentët do të zhvillojnë shkathhtësitë e vëzhgimit, do të njohin elementet bazë të programit me fëmijën në qendër, planifikimin e suksesshëm të punës edukative në këtë nivel arsimor, do të kuptojnë elementet e komunikimit të efektshëm ndërpersonal, si dhe rëndësinë e krijimit të një klime të shëndoshë socio-emocionale në mjedisin shkollor.</p>
11	<p>Komunikimi në arsim</p> <p>Në këtë kurs do të shqyrtohet fillimisht roli dhe rëndësia e komunikimit efektiv në mjedise edukative. Nocionet themelore të komunikologjisë, teoritë e komunikimit, funksionimi i komunikimit ndërpersonal në fëmijërinë e hershme, kanë peshë të veçantë për të trajtuar drejtë problemin. Komunikimi në mes te subjekteve në mjediset edukative, komunikimi si proces i marrjes dhe dhënies se informative, llojet e komunikimit, shkathhtësitë e komunikimit ndërpersonal, klima socio-emocionale për komunikim të efektshëm ndërpersonal, komunikimi edukator-prind, zhvillimi i komunikimit verbal dhe roli i edukatores në këtë proces, domosdoshmërisht do të arsyetojnë kuptimin e qenësisë së kursit në fjalë.</p>
12	<p>Historia e arsimit kombëtar</p> <p>Qëllimi i kursit është njohja e studentëve me zhvillimin historik të arsimit dhe mendimit pedagogjik kombëtar, me idetë pedagogjike të humanistëve shqiptarë, me institucionet kombëtare si: Akademia e re e Voskopojës, Rilindja kombëtare, Mësonjëtorja e parë, Normalja e Elbasanit, me personalitetet kombëtare si: motrat Qiriazi dhe shkolla e vashave, kontributi pedagogjik i vëllezërve Frashëri, P. Bogdanit, P. Budit, Sh. Gjeçovi, A. Xhuvanit, etj.</p>
13	<p>Vizatim</p> <p>Në këtë kurs do të shfrytëzohen njohuritë themelore si: bisedë përgatitore për formën dhe përmbajtjen. Lloje vizatimi: vizatim nga natyra, vizatim dekorativ. Vizatim tematik. Njohuri mbi perspektivën, formën, drejtpeshimin, hapësirën, ritmin. Dekoracionet gjeometrike. Logotipet. Peizazh nga natyra. Skica, Portreti. Autoportreti. Kroki. Karikatura. Ilustrimi me akuarel. Vija, shkarravina dhe vizatimi. Vizatimi për parashkollorë dhe rëndësia e tij. Vizatimi simetrik me ndihmën e</p>

	<p>palosjes. Skica dhe pikturimi në akuarel. Vizatimi, llojet e materialeve dhe përdorimi i tyre. Punimet me tush, bajc, mjetet e duhura për përdorim. Vizatimi si formë e ndërgjegjes shoqërore. Vizatimi dhe pjesët përbërëse të tij. Simbolet e figurave, psikologjia e artit, motivimi i fëmijëve përmes shkarravinave. Vizitë në galeri artesh.</p>
14	<p>Gjuhë shqipe III</p> <p>Në këtë kurs studentet do të marrin njohuri të reja, duke i zgjeruar njohuritë e tyre paraprake, përkthazi me organizimin e tekstit: objektin e studimit të sintaksës, klasifikimin e togfjalëshave, klasifikimin dhe llojet e fjalive për nga struktura e tyre, modaliteti etj., gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët plotësuese të fjalisë. Po ashtu ata do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në fushën klasifikimit dhe të llojeve të fjalisë së përbërë (fjalitë e bashkërenditura dhe fjalitë e nënrenditura).</p>
15	<p>TIK në edukimin fillor</p> <p>Gjeneratat e kompjuterëve. Sistemi kompjuterik. Sistemet operative. Windows. Programet aplikative. Informacionet dhe komunikimet.</p> <p>Qëllimet e mësimit: Njohja e studentëve me historikun e shkurtër të gjeneratës së kompjuterëve, njohja me njësitë themelore të kompjuterit, sistemin operativ WINDOWS, programin aplikativ WORD, programin aplikativ POWERPOINT dhe puna me INTERNET. Aftësimi për të shfrytëzuar programet aplikative në aktivitete me fëmijë. Lojërat arsimore me kompjuter.</p>
16	<p>Teori e mësimit</p> <p>Kuptimi i disa koncepteve themelore të T.E., Zhvillimi i teorisë së kurrikulumit mësimor, Strategjitë aktuale mësimore (nëntë strategjitë), Planifikimi vjetor, tematik dhe konspekti i orës mësimore; Struktura e procesit mësimorë, detyrat – qëllimet/kognitive, afektive dhe psiko-motorike, faktorët e mësimit, sistemet mësimore, format e punës mësimore, përmbajtja mësimore, plani dhe programi mësimor zyrtar, rrjedha e procesit mësimor, rëndësia e njohjes së inteligjencave të shumëfishta për mësim me nxënësin në qendër.</p>
17	<p>Gjuhë angleze II</p> <p>Përvetësimi dhe zgjerimi i njohurive elementare nga lënda e gjuhës angleze; të shtjelluarit e shkathtësive elementare: të folurit, shkrimi dhe leximi në gjuhën angleze. Komunikimi me gojë dhe me shkrim, leximi dhe përvetësimi praktik i gramatikës për këtë nivel.</p>
18	<p>Interpretim me instrumente</p> <p>Kursi është i ndarë në disa pjesë: njohja me instrumentin, mundësitë teknike, pjesët e</p>

	<p>tij, mënyra e interpretimit, interpretimi i shkallëve (C,G, me dy duar dhe D ,A, E, H, FIS, CIS, F, B, ES, AS, DES, GES,CES, me nga një dorë, interpretimi i shkallëve (a, e, me dy duar, h, fis, cis, gis, dis, ais, d, me dy duar g, c, f, b, es, as, me nga një dorë, interpretimi i 8 këngëve me specifika të grupmohës së të vegjëlve, përkatësisht të kl. së parë të shkollës fillore, interpretohen 5 lojëra muzikore përkatësisht 8 këngë të klasës së tretë të shkollës fillore, interpretimi në veglat e Orfit i këngëve të realizuara në instrument klasik, interpretimi i 4 modeleve.</p>
19	<p>Edukatë qytetare</p> <p>Kursi është konceptuar për të përfshirë sa më shumë tematika nga jeta shoqërore.</p> <p>a) Njohuritë: Studentët duhet të fitojnë njohuri solide mbi rrjedhat reale shoqërore dhe domosdoshmërinë e sjelljes bazuar në to; nxitjen e tyre për vetedukim; njohjen me progresin dhe të metat në rrjedhat shoqërore; njohjen se sjellja e qytetëruar është një bazament për progres kombëtar e shtetëror.</p> <p>b) Shkathtësitë: Njëpërmjet njësive të përgjithshme të krijohen shkathtësi motorike për përshtatje çdo situatë konkrete; të mësohen të zbatojnë rregullat e jetës në familje, sjelljes në rrugë, sjellje të duhur në shkollë dhe institucione tjera; respektimin e realitetit politik dhe ekonomik të Kosovës; shmangien nga dukuritë negative dhe krijimin e kulturës qytetëruese.</p> <p>c) Qëndrimet: Studentët duhet të kuptojnë rëndësinë e sjelljes, veshmbathjes dhe raporteve të mira me të gjithë ata që jetojnë dhe bashkëveprojnë; të ketë qëndrim të respektueshëm ndaj natyrës dhe ruajtjes së saj; të ketë qëndrime korrekte dhe mirëkuptimi ndaj minoriteteve dhe të shmangen nga konfliktet e natyrës politike, ekonomike, kulturore, etj.</p>
20	<p>Edukim fizik dhe shëndetësor</p> <p>Kursi ofron informacione në lidhje me zhvillimin fizik dhe lëvizor në fëmijërinë e hershme, që janë mjaft të rëndësishme dhe kanë lidhje të ngushtë me të gjitha fushat e tjera të zhvillimit. Kursi ofron për studentët njohuri për nocionet themelore, për rëndësinë e zhvillimit të shëndetit dhe atij motorik, informacione rreth procesit të zhvillimit motorik, mënyrës se si fëmijët i mësojnë lëvizjet, inteligjencës kinestetike si dhe ide e aktivitete, të cilat mbështesin zhvillimin optimal të fëmijëve në këtë fushë.</p>
21	<p>Shkathtësitë e komunikimit me fëmijë</p> <p>Kursi shtjellon më tutje njohuritë e fituara paraprakisht në kurset e lëndëve psikologjike, për t'i aftësuar studentët t'i zbatojnë ato njohuri në ndërveprimin që kanë me fëmijët. Ndër këto njohuri përfshihen: teoritë e Vigotskit dhe të Piazhësë mbi format e komunikimit dhe punës me fëmijët, informacionet që na</p>

	<p>përcjellin hulumtimet më të reja për format e komunikimit me fëmijë, për ndikimin e të rriturve tek fëmijët, për ndikimet e mjeteve të informimit dhe komunikimit masiv, etj.</p> <p>Kursi ka për qëllim të zhvillojë shkathtësitë e studentëve për të komunikuar dhe ndërvepruar me fëmijë, të zhvillojë shkathtësitë e studentëve për të nxitur bashkëpunimin dhe për zgjidhje të konflikteve, të zhvillojë aftësitë intrapersonale dhe interpersonale të studentëve, të zhvillojë aftësitë e empatisë dhe të dëgjuarit aktiv të studentëve, të zhvillojë të menduarit kritik të studentëve</p>
22	<p>Letërsi për fëmijë</p> <p>Kursi përkufizon krijimtarinë letrare-artistike shqipe dhe botërore që krijohet për fëmijët fillorist nga krijuesit me eminentë shqiptarë dhe botërorë, krijimtari, e cila është e mëvetësishme nga ajo për të rritur.</p>
23	<p>Metodologji e mesimit të matematikës I</p> <p>Përmes këtij kursi studentët do të njihen me rolin dhe rëndësinë e matematikës si shkencë dhe si lëndë mësimore; kurrikulumin e matematikës për nivelin e shkollës fillore; rezultatet e hulumtimeve bashkëkohore në mësimdhënien e matematikës; klasifikimin e problemeve në mësim/nxënien e matematikës; zgjidhjen e problemeve matematikore; materialin didaktik në mësimdhënien e matematikës; tekstet shkollore dhe mësim/nxënien e matematikës; teknologjinë në mësim/nxënien e matematikës; arsimimin matematik dhe revistat shkencore. Në kurs trajtohen edhe metodat kryesore të mendimit dhe hulumtimit në matematikë si dhe zbatimi i tyre në zgjidhjen e problemeve matematike nga jeta e përditshme.</p>
24	<p>Praktika pedagogjike II (5 javë)</p> <p>Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: planifikimi i një njësie mësimore, planifikimi i një serie të njësive të ndërlidhura, vlerësimi dhe notimi i nxënies së nxënësve, përgatitja e mjeteve mësimore, duke përdorur materiale, të cilat janë në dispozicion.</p>
25	<p>Histori kombëtare</p> <p>Kursi është i ndarë në disa pjesë: Fillimet historike nisnin nga civilizimet më të hershme të ilirëve, për t'u lidhur pastaj me civilizimin mesjetar arbëror, si dhe ndikimet e këtij civilizimi në rrjedhat e përgjithshme evropiane, me theks të veçantë në periudhën e humanizmit dhe renesancës evropiane, Rilindjes kombëtare, periudhën e shpalljes së pavarësisë, për të përfunduar me shtetin e Kosovës. Gjatë</p>

	<p>këtij rrugëtimi historik theksi do të vihet, jo vetëm në aspektet politike, që kanë të bëjnë me krijimin e shteteve dhe ndryshimeve në funksionimin e tyre, por edhe në zhvillimet socio-ekonomike, në zhvillimin kulturor dhe intelektual, demografik, në shfaqjen e religjioneve dhe rolit të tyre në marrëdhëniet ndërshqiptare. Gjithashtu programi i kësaj lënde ka për qëllim aftësimin e studentëve në mënyrë që ata t'i bartin përvojat e fituara edhe tek të tjerët.</p>
26	<p>Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla</p> <p>Fokusimi i studentëve në këtë kurs do të drejtohet në disa pika kryesore. Këto janë: dramatizimi i një teksti qoftë ai roman apo tregim. Teksti dramatik i shkurtuar dhe i dramaturgizuar për teatër. Zanafilla e teatrit të kukullave. Zhvillimi i këtij Teatri. Loja e aktorit me kukullën. Pantomima. Teatri i hijeve dhe zanafilla e këtij teatri. Lëvizjet skenike, teknika e zërit, luftërat skenike dhe diksioni. Raporti i aktorit me tekstin. Muzika, kostumografia, skenografia, ndriçimi në teatrin e kukullave.</p>
27	<p>Artet e bukura</p> <p>Në këtë kurs do të shfrytëzohen njohuritë për historinë e artit, për punën në grupe, punën praktike dekorative me letra, formësim gjësëndesh nga kartoni ose letra. Mjetet e punës për kreativitet figurativ dhe përdorimi praktik i tyre. Teknikat e artit figurativ me aplikacion. Përdorimi i shablloneve, kopjimi, prerja dhe ngjitja. Vizatimi simetrik me ndihmën e palosjes. Pikturimi akuarel. kolazhi, mozaiku, metodat dhe avantazhet e aplikimit të tij. Pikturimi, llojet e materialeve dhe përdorimi i tyre. Formësimi me plastelinë e brumë, mjetet e duhura për përdorim. Vizitë në galeri artesh. Ekspozita me punimet më të mira të nxënësve. Ndërtimi i planditarit dhe plankonspektit.</p>
28	<p>Punë dore me modelim artistik</p> <p>Punimet prej letrës: gota, varka, topi, aeroplani, kapela, mjellma, babadimri, fluturakja, mbajtësi i qiriut, pjata, miu, mollëkuqja, qesja e vogël, qesja e madhe, lule prej letre dhe dy punime sipas dëshirës, prej letrës. Punimi i dy modeleve në copë guri natyror. Seminari nga punimet e punuara. Punimi i pemëve dhe perimeve prej plastelinës, lule prej plastelinës dhe gjësënde të tjera. Teknologjia e materialit ndërtimor; punimi i gjerdanit dhe byzylyku prej argjile. Seminar nga punimet e punuara prej materialit ndërtimor dhe plastelinës. Rregullat e mirësjelljes në shtëpi, shkollë, autobus, rrugë, lokal, etj. Punimi praktik nga lëmi i pastërtisë. Punimi praktik i këllëfit për syze, lapsit prej lëkure me dimensione të caktuara si dhe vizatimi në letër në format A4. Punimi seminarik nga lëmi i materialit për tekstil dhe llojet e tekstit. Punim seminarik dhe në mënyrë praktike- ora me akrepa prej kartuçi. Punim praktik për ditët e javës dhe muajt e vitit. Punim seminarik për vitin, muajin, javën, ditët dhe ndërrimin e motit. Punimi i instrumentit muzikor prej stiropori ose fjolla</p>

	bore, semafor ose shkronja. Punimi seminarik me punime praktike mbi rrezikun që i kanoset njeriut gjatë jetës në pakujdesinë e tij. Formimi i figurës dhe trupit gjeometrik prej pjesëve të prera.
29	<p>Strategjite dhe metodat e shkrim leximit</p> <p>Përmes këtij kursi studentët do t'i thellojnë njohuritë e tyre përkitazi me: parimet e drejtshkrimit të shqipes; strukturën e rregullave të drejtshkrimit të shqipes; drejtshkrimin e zanoreve të theksuara e të patheksuara në fjalë; grupet e zanoreve e të diftongjeve; për takimin dhe përdorimin e dy zanoreve të njëjta; apostrofin; theksin; drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve; bashkëtingëlloret e zëshme në trup dhe në fund të fjalës; shkrimi i bashkëtingëllores H; fjalët me rr; nj-ja në trup dhe në fund të fjalës; takimi i bashkëtingëlloreve; takimi i dy bashkëtingëlloreve në fjalë. Po ashtu do të mësohet edhe për disa trajta të shumësit të emrave dhe të mbiemrave; për shkrimin e nyjës së përparme; shkrimi i disa pjesëzave dhe parafjalëve; shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes; përdorimi i shkronjave të mëdha; për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit; për shkrimin e datave, etj.</p>
30	<p>Metodologji e shkencave shoqërore</p> <p>Kursi ofron vizionin e përgjithshëm të zhvillimit dhe formimit të ideve, koncepteve, kategorive shoqërore, në predimensionim të mirëqenies. Ofron të kuptuarit dhe interpretuarit e kategorisë së shoqërisë dhe të fenomenologjisë së saj. Shtron rrafshet e të kuptuarit të botës së shoqërisë, përmes shpjegimit të fenomeneve sociale, antropologjike, politike, ekonomike në strukturën sociale, në forcat sociale dhe në raportet shoqërore.</p>
31	<p>Metodologji e arteve figurative</p> <p>Në këtë kurs do të shfrytëzohen njohuritë themelore si: bisedë përgatitore për formën dhe përmbajtjen. Lloje vizatimi: vizatim nga natyra; vizatim dekorativ, vizatim tematik. Njohuri mbi perspektivën, formën, drejtpeshimin, hapësirën, ritmin. Dekoracionet gjeometrike. Logotipet. Peizazh nga natyra. Skica, Portreti. Autoportreti. Kroki. Karikatura. Ilustrimi me akuarel. Vija, shkarravina dhe vizatimi. Vizatimi për parashkollorë dhe rëndësia e tij. Vizatimi simetrik me ndihmën e palosjes. Skica dhe pikturimi në akuarel. Vizatimi, llojet e materialeve dhe përdorimi i tyre. Punimet me tush, bajc, mjetet e duhura për përdorim. Vizatimi si formë e ndërjegjes shoqërore. Vizatimi dhe pjesët përbërëse të tij. Simbolet e figurave, psikologjia e artit, motivimi i fëmijëve përmes shkarravinave. Vizitë në galeri artesh.</p>
32	Praktika pedagogjike III (6 jave)

Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: planifikimi i njësive dhe programit si dhe planeve individuale për zhvillim e fëmijëve në varshmëri me nevojat, potencialin zhvillimor të tyre, përgatitja e mjeteve mësimore, vlerësimi i nxënies së nxënësve, strategjitë interaktive për të gjithë klasën dhe për grupe të vogla, bashkëpunimi me stafin profesional në shkollë, familje dhe komunitet. Ndërkohë, studentët vetëvlerësojnë ngritjen e tyre profesionale.

33 Bazat e shkencave natyrore metodologji I

Kursi përmban njohuri nga astronomia, fizika, kimia, biologjia dhe synon përgatitjen e studentëve, që këto njohuri t'i interpretojnë për nivelin e shkollës fillore. Në këtë kurs studentët fitojnë dituri të reja për shkencat natyrore dhe lidhjet e tyre në mes njëra-tjetrës. Studentët do të njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e ligjeve të natyrës. Në këtë mënyrë ata formojnë qëndrim të drejtë ndaj ruajtjes së mjedisit jetësor, kursimit të energjisë si dhe fitojnë shkathtësi jetësore e shprehi të punës. Fizika si shkencë e natyrës së bashku me shkencat tjera ndikon fuqishëm në formimin e personalitetit të njeriut, në ngritjen e tij kulturore dhe profesionale.

34 Shkolla dhe komuniteti

Kursi është i ndarë në disa pjesë: Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe praktike të përgatiten për njohjen me rëndësinë e bashkëpunimit të shkollës dhe komunitetit si dhe për zbatimin e kësaj njohurie në praktikë. Studentët do të kenë mundësinë që të njohin dhe aplikojnë forma të ndryshme të bashkëpunimit me komunitetin, duke i stimuluar dhe inkurajuar ata që të organizojnë nga një aktivitet në grupe për të bashkëpunuar me komunitetin në cilësi të mësimdhënësit. Përmes këtij kursi, gjithashtu, synojmë një lëvizje progresive në ngritjen e cilësisë dhe avancimin tek mësimdhënësit e ardhshëm për të parë komunitetin partner shumë të rëndësishëm në punën e tyre profesionale.

35 Arsimimi gjatë gjithë jetës

Kursi ofron përmbajtje bazike për lëndën, që lidhen me të arriturat dhe perspektivat e arsimit gjatë gjithë jetës, në vend dhe më gjerë, duke vijëzuar periudha të ndryshme në aspektin kronologjik-shkencor.

Në kurs përpunohen përmbajtje aktuale të arsimit gjatë gjithë jetës, duke u përqendruar në ecuritë, modalitetet, mjetet si dhe rrethanat favorizuese të kësaj veprimtarie. Po ashtu, kursi është strukturuar në mënyrë që të zbardhë bazën e motivacioneve, interesave dhe qëndrimeve për krijimin e klimës favorizuese për arsimim gjatë gjithë jetës.

Kursi do të ofrojë përmbajtje teorike dhe aktivitete praktike për t'u ndihmuar vijuesve të identifikojnë resurset e shumta që ofron periudha e modernizimit industrial për arsimim gjatë gjithë jetës. Ata do të aftësohen sistematikisht për kërkimin e informacioneve në resurset aktuale për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Kursi do t'u mundësojë vijuesve të zhvillojnë dhe përsosin kulturën për arsimim gjatë gjithë jetës, e cila do të jetë në funksion të përcjelljes së risive në fushën e arsimit gjatë gjithë jetës, edhe pas kryerjes të këtij niveli të arsimimit.

36 Metodologji e leximit letrar

Kursi, *Metodologji e leximit letrar*, përkufizon modelet e leximit të vëmendshëm dhe të kuptueshëm të krijimtarisë letrare-artistike, me qëllim që të nxirret struktura e teksteve letrare, që krijohen dhe perceptohen nga grupmoshat e nxënësve të shkollave fillore. Kjo lëndë përmban shumë faktorë dhe mënyra të shprehjes letrare në një tekst, që na detyrojnë të bëjmë kujdes në përcaktimin sa më të saktë të domethënies së tij, zbulimin e natyrës së fjalëve, interpretimit të tyre, kapjes së synimit të autorit, vokacionit, ritmit të prozës, vargut, strofës. Në programin fillor, përmes librave të leximit dhe lekturave shkollore, si tekst bazë për lexim do të jetë krijimtaria popullore dhe e shkruar për fëmijë nga vepra të ndryshme nacionale dhe botërore.

37 Statistike elementare

Ky kurs është e dizajnuar që të njohë studentët me konceptet themelore dhe metodat e ndryshme statistikore, të cilat aplikohen për hulumtime shkencore pedagogjike. Përmes këtij kursi, studentët do të njihen fillimisht me frekuencat dhe formimin e klasave dhe paraqitjen grafike të gjetjeve, e cila është e pashmangshme për studim të dukurive masive pedagogjike. Pas fazës së parë njohëse me kursin, studentët do mësojnë dhe aftësohen të gjejnë vlerat e ndryshme mesatare, duke u aftësuar të bëjnë ndarjen e një serie ose shpërndarjen e ranguar në dy pjesë të njëjta, duke vijuar me masat e shpërndarjes, të cilat mundësojnë studim të mirëfilltë të dukurive pedagogjike. Kursi i statistikës pedagogjike u mundëson studentëve të mësojnë dhe aftësohen të gjejnë pozitën e rasteve individuale të studimit në grupe. Në hulumtimet pedagogjike përdorim metoda të ndryshme jo parametrike, të cilat janë të përfshira në përmbajtjen e lëndës në fjalë, studentët do të kenë mundësinë fillimisht t'i mësojnë dhe do aftësohen t'i gjejnë ato. Gjithashtu, ata do aftësohen të zbulojnë edhe marrëdhëniet mes dukurive pedagogjike përmes korrelacionit, duke bërë përmylljen e lëndës me aftësim të studentëve për përcaktimin e madhësisë së grupeve reprezentative.

38	<p>Bazat e shkencave natyrore metodologji II</p> <p>Kursi ju dedikohet studentëve, që përgatiten për edukator dhe mësimdhënës klasor, për t'i njohur me jetën e gjallë në përgjithësi, karakteristikat, organizimin dhe funksionimin e saj në të vetmin planet ku ajo dihet se ekziston deri sot. Kursi trajton njohuritë shkencore nga aspektet citologjike, histologjike, organike, fiziologjike, ekologjike, gjenetike dhe evolutive të qenieve të gjalla të përcjella edhe me komponentë metodologjikë dhe didaktikë. Qëllimet kryesore të kursit janë: njohja me jetën dhe organizimin e saj, klasifikimi i organizmave në mbretëritë kryesore të botës së gjallë, kompleksiteti i funksionimit të jetës së gjallë, riprodhimi dhe zhvillimi te bimët, shtazët dhe njeriu, evolucioni i formave të jetës së gjallë dhe ngjarjet kryesore në evolucion, marrëdhëniet e organizmave të gjallë me mjedisin e jashtëm.</p>
39	<p>Edukimi gjithëpërfshirës me metodologji</p> <p>Njohuritë mbi nocionet dhe bazat e gjithëpërfshirjes në edukimin fillor. Vëzhgimi, identifikimi dhe vlerësimi i foshnjave dhe i fëmijëve me nevoja të veçanta. Intervenimi i hershëm, shërbimet e hershme dhe plani individual i arsimit (PIA). Edukimi gjithëpërfshirës i fëmijëve me: retardim mental, sindromën e Down-it, autizëm, dëmtime në të dëgjuar dhe të parë, invaliditetet trupor, çrregullime të të folurit, gjuhës dhe zërit, disleksi, disgrafi dhe diskalkuli, si dhe i fëmijëve të talentuar.</p>
40	<p>Psikologji edukimi</p> <p><i>Psikologjia e edukimit</i> synon të japë njohuri për zhvillimin, të nxënit dhe mësimdhënien. Kursi do të trajtojë çështje mbi edukimin e fëmijëve që nga lindja deri në moshat e rritura, zbatimin e psikologjisë në studimin e zhvillimit, të nxënit, mësimdhënies, motivimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me procesin e edukimit si dhe aplikimin praktik të parimeve psikologjike të mësimdhënies.</p>
41	<p>Edukimi mjedisor</p> <p>Kursi ofron bazat e edukimit të gjeneratave të reja për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Edukimi mjedisor sot shërben si mekanizëm për të plotësuar aktivitetet e botës bashkëkohore për një sjellje më miqësore ndaj mjedisit dhe një zhvillim të qëndrueshëm. Me anë të kursit studenti do të fitojë njohuritë bashkëkohore mbi edukimin mjedisor dhe zhvillimin e qëndrueshëm duke përfshirë: konceptet kyçe mjedisore si: biosfera dhe funksionimi i saj, ndotja dhe pasojat, aktivitetet zhvillimore me ndikim në mjedis, kërcënimet kryesore për mjedisin dhe problemet globale mjedisore, mbi mekanizmat globalë, evropiane dhe nacionalë për mbrojtjen e mjedisit dhe njohuritë bazë mbi mjedisin e vendit tonë dhe problemet kryesore të tij si dhe</p>

	<p>masat për ngritjen edhe përmirësimin e sjelljes mjedisore të fëmijëve.</p> <p>Përmes kursit studentët do të aftësohen që të interpretojnë dhe transmetojnë njohuritë për mjedisin dhe mbrojtjen e tij tek nxënësit me të cilët punojnë, por në mënyrë indirekte edhe ndikimin më të gjerë në familje dhe shoqëri për zhvillim të qëndrueshëm.</p>
42	<p>Zhvillimi i kurrikulave</p> <p>Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësi të njihen me rëndësinë e Kurrikulës në planifikimin dhe organizimin e orëve mësimore. Do të kenë mundësi që të analizojnë dhe zbërthejnë në praktikë Kurrikulën Bertham. Gjithashtu kursi ofron orjentimin e mësimdhënësve të ciklit fillor për të trajtuar dokumentin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës dhe Kurrikulën Berthamë 1, në të cilën përfshihet edhe klasa parafillore, klasa I dhe II.</p> <p>Kursi do të trajtojë edhe format e vlerësimit të kompetencave sipas shkallës.</p>
43	<p>Vështirësitë në të nxënë</p> <p>Njohuritë mbi nocionet dhe bazat e vështirësive në të nxënë. Llojet e vështirësive në të nxënë – modelet e klasifikimeve. Definicionet dhe karakteristikat e vështirësive në të nxënë. Terminologjia, definicionet, aspektet edukativo-arsimore të disleksisë, disgrafisë dhe diskalkulisë. Vështirësitë në të nxënë si pasojë e çrregullimeve në të folur dhe gjuhë, dëmtimeve në të dëgjuar, në të parë, prapambetjes intelektuale, çrregullimeve në sjellje, si dhe pranisë së njëkohshme të llojeve të ndryshme të vështirësive në të nxënë.</p>
44	<p>Etika e mësimdhënies</p> <p>Në kurs trajtohen të drejtat dhe obligimet morale, që duhet t'i posedojë mësimdhënësi për të realizuar raportet ndërnjerëzore në veprimtarinë arsimore. Kursi promovon tri aktivitetet kryesore të veprimtarisë arsimore të mësimdhënësit, duke filluar nga dituritë, vendimmarrja dhe sjellja, si shkathësi të pashmangshme, të cilat e karakterizojnë personalitetin e mësimdhënësit.</p>
45	<p>Edukimi dhe mediet</p> <p>Edukimi medial është proces përmes të cilit individët pajisen me arsimim për mediet, arrijnë ta kuptojnë medien në mënyrë kritike, në radhë të parë natyrën, teknikat dhe ndikimet e mesazheve të medieve dhe prodhimeve mediale. [Kjo nënkupton mendimin kritik për tekstet mediatike deshifrim, analizë dhe vlerësim të medias]. Në anën tjetër, në shkollat moderne ka një vetëdije në rritje për nevojën e të mësuarit në klasë për botën reale, duke sjellë përmbajtje mediale. Nga ky aspekt,</p>

	<p>përdorimi i medias në shkolla është përparësi. Po ashtu, bota virtuale televizioni, kompjuteri, interneti etj. po dëshmojnë gjithnjë e më shumë edhe si një faktor që ndikon në izolimin e individit, duke i afruar atij një modus të jetës virtuale. Ky është një keqkuptim, i cili duhet të diskutohet vijimisht në procesin e edukimit të nxënësve.</p>
46	<p>Metodologji e mësimit të matematikës II</p> <p>Përmes këtij kursi studentët do të zhvillojnë këto tema: Nxënia dhe konstruktimi i njohurive të nxënësve për bashkësitë numerike dhe operacionet – paraqitja, proceset, hapat dhe nivelet, qasjet; kuptimi dhe konstruktimi i njohurive gjeometrike – VanHiele nivelet e të kuptuarit në gjeometri- gjeometria planare, parakonceptet e vërtetimeve gjeometrike dhe deduktiviteti; të kuptuarit dhe konstruktimi i njohurive të nxënësve për matjet dhe masat – përpunimi i numrave decimal me anë të matjes; të kuptuarit e njohurive fillestare algjebrike – shembuj, veprimet brenda një bashkësie; ndërtimi i konceptit të funksionit – paraqitjet, prezantimi dhe elementet përbërëse të konceptit të funksionit, shembuj; ndërtimi dhe përpunimi i konceptit të ekuacioneve – shembuj; përgatitja e orës mësimore, të kuptuarit, performancat e të mësuarit, strategjitë e të mësuarit.</p>
47	<p>Histori e letërsisë kombëtare</p> <p>Kursi përkufizon krijimtarinë letraro-artistike të krijuar në gjuhën shqipe nga autorët më eminentë. Ky kurs argumenton rëndësinë e madhe që ka prodhimi letrar artistik kombëtar. Kjo letërsi duke bërë ndikim estetik në marrësin (dëgjuesin dhe lexuesin fëmijë e të rritur) mundëson pasurimin shpirtëror të tij, njohjen e botës dhe vetvetes, e bën dijen dhe edukimin më të qëndrueshëm.</p>
48	<p>Metodologji e edukimit fizik</p> <p>Përmes aplikimit të saj në procesin e mësimdhënies mundësohet organizimi, zhvillimi dhe rrjedha e mësimit në nivelin më të lartë profesional, duke ju përshtatur kushteve dhe kërkesave metodiko – didaktike.</p>
49	<p>Metodologji e gjuhës shqipe</p> <p>Përmes këtij kursi studentët do të njihen me rolin dhe rëndësinë e gjuhës si shkencë dhe si lëndë mësimore; kurrikulumin e gjuhës për nivelin e shkollës fillore; rezultatet e hulumtimeve bashkëkohore në mësimdhënien e gjuhës; klasifikimin e çështjeve në mësim/nxënien e gjuhës; diskutimin e problemeve drejtshkrimore; materialin didaktik në mësimdhënien e gjuhës; tekstet shkollore dhe mësim/nxënien</p>

	<p>e gjuhës; teknologjinë në mësim/nxënien e gjuhës; arsimimin gjuhësor dhe revistat shkencore. Në kurs trajtohen edhe metodat kryesore të mendimit dhe hulumtimit në gjuhësi/gramatikë si dhe zbatimi i tyre në zgjidhjen e problemeve të komunikimit nga jeta e përditshme.</p>
50	<p>Etnologji dhe letërsi popullore</p> <p>Kursi synon paraqitjen e fondit etnokulturor të vlerave artistike e shpirtërore, të normave dhe marrëdhënieve, praktikave, besimeve, dokeve e zakoneve, shenjë e identitetit kombëtar, e aftësisë krijuese, e psikes estetike të shqiptarët, si themel e pikënisje nga mund të shpjegohen disa dukuri e prirje karakteristike për letërsinë e shkruar shqipe.</p>
51	<p>Vlerësimi në arsim</p> <p>Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: rëndësia e vlerësimit në arsim, qasjet teorike rreth vlerësimit në arsim, njohja dhe zotërimi i aftësive për zbatimin e teknikave formale për vlerësim siç janë: dosja e punës së nxënësve, performanca e tyre, lista e kontrollit, regjistrime të ndryshme të sjelljes përmes magnetofonit, kamerave, fotove, vizatimet e fëmijëve, si dhe planifikimi i procedurës së vlerësimit. Peshë të veçantë në vlerësim ka dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura përmes këtyre teknikave. Qëllimi i kursit është njohja e studentëve me përvojat që përfshijnë strategjitë, të cilat çojnë në vlerësimin autentik, diagnostik, formativ, përmbledhës. Kursi do të përfshijë gjithashtu theksin mbi teknikat efektive të vlerësimit alternativ.</p>
52	<p>Psikologjia zhvillimore dhe e personalitetit</p> <p>Kursi ofron njohuri të përgjithshme mbi zhvillimin e personalitetit të edukatorit dhe të fëmijës. Kursi shtjellon në detaje teoritë e ndryshme për zhvillimin e personalitetit, stadet në teoritë zhvillimore, hulumtimet kryesore në fushën e personalitetit dhe ndikimet kryesore në zhvillimin e personalitetit; tiparet themelore të personalitetit, vlerat, besimet dhe ndikimet e trashëgimisë dhe edukimit, njohuri të përgjithshme për çrregullimet më të shpeshta të personalitetit dhe ndikimin që këto çrregullime kanë tek individi, familja dhe shoqëria në përgjithësi.</p>
53	<p>Menaxhimi i klasës dhe disiplina</p> <p>Ky kurs është i dizajnuar për të mbështetur mësuesit në zhvillimin e një qasjeje praktike, efektive të menaxhimit në klasë. Fillimisht studentët do të kuptojnë për rëndësinë e menaxhimit në klasë, shpjegohet konteksti historik i disiplinës dhe menaxhimit në klasë si dhe teoritë kryesore mbi sjelljen njerëzore. Menaxhimi në klasë, përmes organizimit të punës së mbështetur në rregullat dhe procedurat e caktuara është më se i nevojshëm, në mënyrë që të përmbushen qëllimet edukativo-arsimore. Menaxhimi efektiv në klasë mund të përdoret për krijuar klimë socio-</p>

	<p>emocionale pozitive aty, çka nënkupton njëherazi edhe minimizim të sjelljeve përçarëse. Për të arritur këtë realizohet mësimi kooperues, respektimi i stileve të të nxënit, organizimi në bazë të afiniteteve të fëmijëve, vlerësimi i drejtë dhe transparent, si dhe shumë strategji të komunikimit, të cilat ndihmojnë në menaxhimin në klasë. Strategjitë për planifikimin dhe menaxhimin e kohës mësimore në klasë: menaxhimin e kohës dhe problemet tipike me tranzicionin, janë ndërkohë dhe çështje tjera me rëndësi për menaxhim të efektshëm në klasë.</p>
54	<p>Fëmijët dhe mësimi në natyrë</p> <p>Kursi është i ndarë në disa pjesë: pjesa e koncepteve të përgjithshme të natyrës dhe raport i njeriut me natyrën. Aktivitetet edukative e rekreative: fëmijët dhe trashëgimia natyrore; parqet nacionale dhe zonat e mbrojtura, vlerat edukative, ruajtja e ekosistemeve dhe rekreacioni. Roli i ecjes, ngjitjes, alpinizmit, turizmit dhe aktiviteteve tjera përcjellëse në natyrë. Zonat e trashëgimisë natyrore dhe ekskursionet në Kosovë: zonat kryesore të vizituara, vlerat dhe statusi i tyre, pse dhe si mbrohen ato? Edukimi në natyrë: vizita në kopshtet botanike/lulishte e zoologjike, muze natyrorë, etj.</p>
55	<p>Bazat e hulumtimit në edukim</p> <p>Do të shqyrtohen çështje të tilla si: qasjet teorike të metodologjisë së hulumtimit në çështjet e arsimit në përgjithësi, zotërimi i aftësive për zbatimin e metodave të hulumtimit dhe të të nxënit për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë, për përgatitjen e punimeve të ndryshme e sidomos të punimit të diplomës, diskutimet e të nxënit në bashkëpunim me të tjerët, komunikimi dhe prezantimi i rezultateve të hulumtimit.</p>
56	<p>Praktika pedagogjike IV (8 javë)</p> <p>Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: planifikimi i punës edukative sipas karakteristikave të moshës në fëmijërinë e hershme, si dhe veçantive të programit me të cilin punohet. Do të punohet më konkretisht në plane individuale për zhvillimin e fëmijëve në varshmëri me nevojat, potencialin zhvillimor të tyre, por edhe në vlerësimin e zhvillimit të fëmijëve në dimensione të ndryshme, do të diskutohet përgatitja e mjeteve mësimore, strategjitë interaktive për grupe të vogla, bashkëpunimi me stafin profesional në institucionin parashkollor, me familjen dhe komunitetin. Ndërkohë, studentët vetëvlerësojnë ngritjen e tyre profesionale.</p>
57	<p>Punimi i diplomës</p>

Punohet në bashkëpunim me profesorin mentor sipas rregullores së Fakultetit të Edukimit për studime Bachelor.